



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Ejona" Sh.P.K. të datës 19.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 14.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-3831-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Ejona" Sh.P.K. e datës 19.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 14.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-3831-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Ejona" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Ejona" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 19.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 14.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Instalimi dhe rregullimi i Liftave të objekteve të Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-3831-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): "Ne DT dhe ne Njoftimin per kontrat, AK ka kerkuar: 2.Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme c. 3 teknike të ndërtimtarisë Minimumi 3 vite përvojë pune në punë. Deshmite: 2. CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Ndersa, OE UP LIFT ka prezantuar Diplomen dhe CV, vetem per 1 teknik te ndertimtarise, me saktesisht z. Fadil Hasani. Pra, OE i shpallujr fitues nuk ka permbushur kerkesen ne DT per aftesine profesionale dhe teknike".

Pretendimi i dytë (II): "OE i shpallur fitues, ka prezantuar ISO certifikatat e kerkuara tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale , mirepo keto certifikata jane te leshuara dhe valide me daten 18.05.2023 (pra vetem 1 dite para hapjes se tenderve". Andaj, ky OE nuk ka deshmuar se i ploteson KËRKESAT MINIMALE TË KUALIFIKIMIT, perkatesisht: Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale deshmi te cilat duhet te jene faktike PARA Dates se Njoftimit per Kontrat. Pra, ne qofte se OE "UPLIFT" nuk deshmon se ka plotesuar kerkesat para dates se Njoftimit per Kontrat, i njejti OE duhet diskualifikuar nga aktiviteti i prokurimit".

Pretendimi i tretë (III): "OE "UPLIFT" nuk ka plotesuar çmimin e : B. PUNËT E ASHENSORIT - REKAPITULIM".

Duke u bazuar te pretendimet si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues kishte për të vepruar në kundërshtim me nenin 51, 52, 56, 59 dhe 69 të LPP.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 23.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parë (I): fillimisht duhet cekur se sipas dosjes së tenderit në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ndër të tjera janë kërkuar edhe "c. 3 teknike të ndërtimtarisë Minimumi 3 vite përvojë pune në punë". Nga dokumentet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar është gjetur se tenderuesi i rekomanduar ka dëshmuar pikërisht për tre (3) teknike të ndërtimtarisë me minimumi 3 vite të përvojës së punës të cilët janë 1. Fadil Hasani; 2. Genc Mani dhe 3. Naim Statovci. Pra nuk është aspak e vërtetë që tenderuesi i rekomanduar ka dëshmuar vetëm për një teknik të ndërtimtarisë (Fadil Hasanin) sikurse pretendon parashtruesi. Përndryshe tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar edhe dëshmitë e kërkuara sipas dosjes së tenderit lidhur me listën e stafit. Në anën tjetër nga raporti i vlerësimit është gjetur se komisioni vlerësues ka gjetur se tenderuesi i rekomanduar e ka plotësuar me rregull edhe këtë kriter të DT. Prandaj pretendimi i parë i parashtruesit është në tërësi i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë (II): sipas dosjes së tenderit në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ndër të tjera janë kërkuar edhe "Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 18001". Dëshmia e kërkuar në këtë rast janë "Kopjet e certifikatave valide ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 18001".

Nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar është gjetur se operatori ka dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara sipas DT dhe ky fakt nuk kontestohet as nga parashtruesi. Po ashtu është konfirmuara se të gjitha këto certifikata në momentin kur janë dorëzuar me ofertën kanë qenë valide (me datë 18.05.2023) dhe validiteti i tyre zgjat deri me datë 17.05.2028. Sidoqoftë pretendimi i parashtruesit është se këto certifikata është dashur që të jenë valide para se jetë publikuar njoftimi për kontratë. Mirëpo një pretendim i tillë nuk përcaktohet askund në dosjen e tenderit. Me fjalë të tjera në dosjen e tenderit nuk është kërkuar askund që këto certifikata duhet të jenë valide para se të publikohet njoftimi për kontratë. Rrjedhimisht komisioni vlerësues me të drejtë ka gjetur se tenderuesi i rekomanduar e plotëson edhe këtë kërkesë të DT. Prandaj pretendimi i dytë i parashtruesit është në tërësi i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e tretë (III): nga dokumentet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar konkretisht nga lista e çmimeve është gjetur se tenderuesi i rekomanduar ka përcaktuar edhe çmimin për punët e ashensorit dhe atë në shumë 24,000.00 Euro. Ky fakt dëshmohet edhe nga figura si më poshtë. Në anën tjetër nga raporti i vlerësimit është gjetur se komisioni vlerësues ka gjetur se tenderuesi i rekomanduar e ka plotësuar me rregull edhe këtë kriter të DT. Prandaj pretendimi i tretë i parashtruesit është në tërësi i pabazuar.

| A. PUNËT NDËRTIMORE - REKAPITULIM | | | | | |
|---|--|----------------|-------|------------------|-------------------|
| POS. 1 | PUNËT PËRSHKORTORË | | | 50.00 | |
| POS. 2 | PUNËT DËMOLLËSE | | | 281.00 | |
| POS. 3 | PUNËT E OHEJUT DHE MËNGJUA | | | 158.00 | |
| POS. 4 | PUNËT E BETONIT, ARMATURËS DHE HORIZOZOLIMIT | | | 1,211.49 | |
| POS. 5 | PUNËT ME ÇELIK (KAPRATA LINEARE) | | | 4,994.88 | |
| POS. 6 | PUNËT E MËSHKURËS ME PANJELË KOMPOSITE - ALUZHIBOND | | | 7,025.00 | |
| POS. 7 | PUNËT TËJERA | | | 2,168.20 | |
| TOTAL - PUNËT NDËRTIMORE: | | | | 15,973.23 | |
| B. PUNËT E ASHENSORIT | | | | | |
| Pos. | Përshkrimi i artikullit | Nëfshë matëse | Baza | Totali (€) | |
| 1.1 | Mbrojtje në hapë të hirtësve së investitorit duhet të instalohet ashensori elektrik (2-830 kg, 8 persona) edhe në prapësirë të brendshme të apartamenteve sipas Ligjit Nr. 044-041 Për Punëtim, Transport dhe mbajtje të ashpër elektrike 630 kg për 8 persona sipas projektit detaj (Kabina 1100x1400 mm; Dyert e Kabinit: 900x2000, copë 1 Automatikë; Dyert për hyrje nga koridorë:900x2000, 3 copë Automatikë; Komandë e Kabinit; Mbrojtje; Shiritësi i Mbrojtjes; Bufet për Kabina-Amerikanet; Shtesë për Kabina Lloj: 900x300; Rregullator i Shpejtësisë, Tretat, Inventor, etj. etj. Mbrojtjes/mbajtje së | Copë | 1.00 | 24,000.00 € | |
| TOTALI POSICIONE: | | | | 24,000.00 | |
| C. PUNËT E ASHENSORIT - REKAPITULIM | | | | | |
| TOTAL - PUNËT E ASHENSORIT: | | | | | |
| D. PUNËT ELEKTRIKËS | | | | | |
| Pos. | Përshkrimi i artikullit | Nëfshë matëse | Baza | Totali (€) | |
| 1.2.1 | Furnizimi dhe montimi i tabelës shpërndarëse elektrike për Përdorues (KSH-P)Me mbrojtje IP43, 36 modula, me lëviz tërësisht | copë | 1.00 | 10.00 € | |
| 1.2.2 | Furnizimi dhe montimi i mbrojtjes diferenciale automatike ose rrymë normale In=63A dhe rrymë diferenciale In=0.03A, | copë | 1.00 | 10.00 € | |
| 1.2.3 | Furnizimi dhe montimi i siguruesve automatike rregullues me karakteristika veçoritë C për rrymë normale In=25A | copë | 1.00 | 10.00 € | |
| 1.2.4 | Furnizimi dhe montimi i siguruesve automatike rregullues IP+N me karakteristika veçoritë C për rrymë normale In=16A, | copë | 10.00 | 9.00 € | |
| 2.2 | Furnizimi dhe montimi i tabelës energjetike NVM-1-faktorë C, për furnizimin e ashensorit MEGOLIN ose të ngjashëm | m ² | 32.00 | 5.00 € | |
| TOTALI PUNËT E ELEKTRIKËS: | | | | 389.00 € | |
| REKAPITULIM PARAMASA DHE PARALLOGLARIA E PUNËVE NDËRTIMORE PËRSHKORTORË (PUNËT) | | | | | |
| Nr. | | | | Shuma totale (€) | |
| A | PUNËT NDËRTIMORE | | | 15,973.23 | |
| B | PUNËT E ASHENSORIT | | | 24,000.00 | |
| C | PUNËT ELEKTRIKËS | | | 389.00 | |
| Totali me TVSH: | | | | 40,362.23 | |
| TVSH 15%: | | | | 6,054.33 | |
| Totali me TVSH: | | | | 46,416.56 | |
| REKAPITULIM PËRPLUMONTAR | | | | | |
| REKAPITULIM I PARAMASESË DHE PUNËVE PËR ADAPTIMIN E ASHENSORËVE NGA HIDRAULIK NË ELEKTRIK | | | | | |
| | | | | Shuma | 105,000.00 |
| | | | | Shuma | 46,416.56 |
| Totali me TVSH: | | | | | 151,416.56 |

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 23.06.2023


Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Ffishitines



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.